

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

### PREVENTIV

	Pershkrimi	Vlera
1	Paga baze per nje punonjes sherbimi	
2	Shtese per Sherbime	
3	Shuma (1+2)	
4	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	
5	Shuma (3+4)	
6	Shpenzime uniforme	
7	Shpenzime armatimi	
8	Shpenzime nderlidhjeje	
9	Fitimi i llogaritur	
10	Shuma ne muaj per nje roje (5+6+7+8+9)	
11	Shuma per 4.8 roje gjithesej ne nje muaj	
12	Shuma per sherbimin e kerkuar	
13	TVSH	
14	Total	

#### Shenim:

**Bashkelidhur ofertes cdo operator ekonomik krahës formularit të cmimit të ofertes dhe preventivit përmbledhës do të paraqes dhe një analizë të hollësishme të zërit kryesor të shpenzimit paga, shtesa mbi page, sigurimet shoqerore, armatim etj.**

Ne llogaritjen e ofertës, duhet të kenë parasysh dhe pasqyrojnë elementët më të domosdoshëm të strukturës së kostos: pagat dhe shtesat mbi page, numrin e **rojeve (4.8 roje gjithsej)**, sistemin e pandërprerë të punës, ditët kalendarike, ligjet, vendimet dhe udhëzimet në fuqi në lidhje me pagën bazë minimale mujore, llogaritjen e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore, shtesat mbi page për turnet e dyta dhe të treta mënyrën e pagesës së tyre sipas Kodit të Punës. (Në mënyrë që të mundësohet verifikimin e vlerave minimale nëse janë në përputhje me aktet ligjore e nenligjore në fuqi). **Autoriteti kontraktor do të skualifikoj të gjithë operatorët që kanë paraqitur vlerat e zërave të lartpërmendur në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.**

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula \_\_\_\_\_

Objekti: “Shpenzime për sigurimin dhe ruajtje fizike Spitalit Mallakaster”

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimit:

- Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë do të përfshijë sigurimin e ambienteve të Spitalit Mallakaster , me adresë: lagja 5 Shkurti Ballsh.
- Kryerja e shërbimit është në 1 (nje) vend-roje.
- Numri i punonjësve të shërbimit (rojeve) duhet të jetë 4.8 (kater pike tete).
- Koha e shërbimit të jetë 24 orëshe, për çdo ditë kalendarike dhe festa zyrtare sipas afateve të kontratës.
- Të njihet dhe të respektohet rregullorja e Institucionit gjatë kohës së kryerjes së shërbimit.

**SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

- **Shërbimi që kërkohet:** Sigurimi dhe ruajtja fizike e ambienteve të Spitalit Mallakaster , me adresë: lagja 5 Shkurti Ballsh.
1. Të sigurojë dhe të ruajë ambientet ku ushtrohet veprimtaria dhe aktiviteti i Spitalit Mallakaster nga demtimet dhe vjedhjet e mundshme.
  2. Shërbimi i punonjesit të shërbimit do të jetë me uniformën e caktuar dhe me kartën e identitetit personal, për çdo punonjës shërbimi.
  3. Punonjësit e shërbimit të jenë të pajisur me mjete ndërlidhje për komunikim si dhe duhet të jenë të pajisur me armë për parandalimin e ndalimin e veprimtarisë së keqbërësve në dëm të objektit që ka nën ruajtje dhe nën përgjegjesinë personale të tij.
  4. Shërbimi i ruajtjes e sigurimit fizik të objektit do të jetë 24 orësh për 1 (një) vend-roje, për çdo ditë kalendarike dhe festat zyrtare sipas afateve të kontratës.
  5. Përveç shërbimeve të mësipërme, marrëdhëniet më të detajuara midis kontraktuesit dhe Spitalit Mallakaster do të jepen në rregulloren e posaçme që do të jete pjesë përbërëse e kontratës.

**SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

**Shërbimi që kërkohet:** “Shpenzime për sigurimin dhe ruajtjen e Spitalit Mallakaster.

## AFATET E EKZEKUTIMIT :

Afati i ekzekutimit do të fillojë nga date 06.02.2017 (lidhja e kontratës) deri me 31.12.2017.

**Sqarim:** Në ofertë të jenë të përfshira të gjitha shpenzimet e përgjithshme, për uniformat (veshmbathjen), armatim, ndërlidhje (si radiomarrës etj), shpenzimet për pagën e rojeve, shtesat mbi pagën për turnin e dyta (ora 19.<sup>oo</sup> - 22<sup>oo</sup>), shtesat mbi pagën për turnin e tretë (ora 22.<sup>oo</sup> - 06<sup>oo</sup>), shtesat mbi pagën për ditët e pushimeve dhe ditët e festave, sigurimet shoqerore dhe shëndetësore si dhe të gjitha detyrimet fiskale që parashikon legjislacioni në fuqi, për 4.8 roje me 1 vendroje sipas turneve në Spitalin Mallakaster.

Afatet e ekzekutimit: Nga 06.02.2017 (lidhja e kontratës) deri më 31.12.2017.

Grafiku i ekzekutimit të shërbimit:

Nr.	Objekti i Prokurimit	Periudha në muaj	Nr. Rojeve	Nr.Vend-roje	Turnet/Vendroje
1.	Shpenzime për sigurimin dhe ruajtje fizike të zyrave të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural	10.75	4.8	1	1 (T1+T2+T3)

## **TERMAT E REFERENCËS**

### Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Të sigurojë dhe të ruajë ambientet e Spitalit Mallakaster nga dëmtimet e vjedhjet e mundshme.

### Detyrat:

Shoqëria duhet të marrë përsipër zhdëmtimin 100% të dëmeve që vijnë për shkak të mos kryerjes si duhet të shërbimit nga punonjësit e shoqërisë.

Rojet të jenë të pajisur me armë dhe mjete të tjera mbrojtëse, me uniformë të veçantë dhe dokumenta që vërtetojnë identitetin e tyre. Gjatë turneve të dyta dhe të treta rojet të kryejnë kontrole çdo 15 minuta në të gjitha hapësirat e objektit.

**Objektivat:** Të ruajnë me përkushtim objektin dhe rendin në Spitalin Mallakaster.

**Roja ka për detyrë:**

- Të sigurojë vendparkimin e ndodhur përpara Spitalit Mallakaster, ku do të parkohen automjetet e institucionit.
- Para marrjes së shërbimit, kontrollon objektin në prezencë të rojes dorëzuese dhe për çregullimet e konstatuara njofton përgjegjësën e rojeve dhe ate të Spitalit Mallakaster, duke bërë shënimet përkatëse në librin e shërbimit.
- Në rast zjarri merr masa për shuarjen e tij dhe menjëherë njofton zjarrëfikset.
- Kur në objekt kryhen vepra penale, roja bën bllokimin e mjedisit dhe të autorit dhe njofton menjëherë organet kompetente.
- Roja përdor armën në bazë të gjithë legjislacionit në fuqi.
- Roja i objektit për kryerjen e detyrave të tij bashkëpunon me policinë e rendit.
- Roja për marrjen e detyrës sipas grafikut duhet të paraqitet 15 min para fillimit të turnit. Atij i ndalohet largimi nga vendi i kryerjes së shërbimit pa u zëvendësuar dhe pa marrë miratimin e përgjegjësit.
- Ndalohet futja dhe qendrimi i rojës në ambjentet e brendshme të objektit përjashtuar rastet për zbatimin e rregullores.
- Roja gjatë kohës së shërbimit duhet të karakterizohet nga sjellja qytetare në komunikim me personat.
- Rojes, gjatë kohës së shërbimit, i ndalohet të pijë pije alkolike, të flejë, të bisedojë me njerëz të jashtëm.
- Roja duhet të zbatojë vetëm urdhërat e përgjegjësit të rojeve dhe drejtorave përkatës.
- Ndalohet kategorikisht marrja e armatimit me vete, por t'i dorëzohet me proces verbal rojes së rradhës.

- Roja duhet të kryejë detyrat e përcaktuara në Ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” e në aktet nënligjore, si dhe detyrat e dhëna nga drejtuesi teknik i subjektit;
- Roja duhet të zbatojë me korrektësi detyrat për ruajtjen e objektit dhe të mbajë lidhje të vazhdueshme me drejtuesin teknik;
- Roja duhet të mbajë sipas rregullores, armatimin personal e pajisjet e shërbimit, të përdorë uniformën, shenjat dhe simbolet e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike vetëm gjatë kryerjes së detyrës;
- Roja duhet të kryejë detyrat për ruajtjet e vendit të ngjarjes në territorin e shërbimit, të bëjë identifikimin e personave që lidhen me ngjarjen dhe të vihet në dispozicion të strukturave të Policisë së Shtetit për hetimin e ngjarjes në objektin që siguron;
- Roja duhet të japë informacionin e mundshëm në funksion të kryerjes së detyrave të Policisë së Shtetit;
- Roja duhet të vihet në dispozicion të strukturave të Policisë së Shtetit, sa herë që kërkohet, për parandalimin e veprave penale dhe zbulimin ngjarjeve të ndodhura në mjedisin ku kryen detyrën ose në ato të lidhura me detyrën;
- Roja duhet të komunikojë me transparencë, etikë dhe konform kërkesave të ligjit me qytetarët, eprorët dhe me çdo autoritet ligjzbatues, kur kërkohet një gjë e tillë;
- Roja duhet të mos përdorë mjetet e transportit e të dhëna për interesa personale, për vete dhe për të tretët;
- Roja duhet të ruajë e të mirëmbajë mjetet e ndërlihdjes e ndriçimit, si dhe pajisjet e tjera të dhëna për përmbushjen e detyrës;
- Roja duhet të plotësojë detyrimet financiare që vijnë nga masat administrative;
- Roja duhet të mos vendosë në uniformë dhe në mjetet e transportit simbole apo shenja të tjera, përveç atyre të miratuara nga legjislacioni përkatës në fuqi;
- Roja duhet të ruajë cilësitë morale, kodin etik për komunikim dhe sjellje qytetare, si dhe të mos përdorë pije alkoolike, droga e lëndë narkotike në shërbim.

Në vend-roje duhet të gjenden këto dokumenta:

a) Rregullorja e brendshme;

- b) Libri i marrjes në dorëzim të shërbimit;**
- c) Grafiku i shërbimit;**
- d) Inventari i materialeve që ndodhen në objekt;**
- e) Mjete ndriçimi në rast mungese energjije elektrike;**
- f) Listën e automjeteve që lejohen të hyjnë apo të parkohen në objekt.**
- **Roja për probleme urgjente të shërbimit përdor mjetet e ndërlidhjes së objektit.**
- **Ndalohet ndërrimi i grafikut të shërbimit pa miratimin e përgjegjësit të rojeve.**

**Shpërndarja:**

**Numri i punonjësve të shërbimit (rojeve) duhet të jetë 4.8 (kater pik tete).**

- **Koha e kryerjes së shërbimit do të jetë 24 orëshe, për çdo ditë kalendarike dhe festë zyrtare sipas afateve të kontratës.**

**Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:**

**Vendi i dorëzimit të shërbimit do të jetë në vëndrojen e Spitalit Mallakaster qyteti Ballsh.**

